

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET**

**MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË
REPUBLIKËS SË PANAMASË**

DHE

**MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË
REPUBLIKËSSË KOSOVËS**

**RRETH BASHKËPUNIMIT NDËRMJET AKADEMIVE TË DY
MINISTRIVE**

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Panamasë, përmes Akademisë Diplomatike "Ernesto Castillero Pimentel", dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, përmes Akademisë Diplomatike (tash e tutje të njohura si "Palët"),

Duke **NJOHUR** natyrën e bashkëpunimit që ekziston ndërmjet Panamasë dhe Kosovës, dhe;

TË GATSHME që të promovojnë një bashkëpunim më të ngushtë në shkollat e diplomatëve;

Janë pajtuar, si në vijim:

**NENI 1
QËLLIMI**

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MOU) është krijimi i kushteve për mbajtjen e kontakteve periodike dhe promovimi i bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

**NENI 2
BASHKËPUNIMI**

Palët do të bashkëpunojnë në këmbimin e informatës dhe të përvojave në lidhje me programet e tyre përkatëse të studimit dhe të hulumtimit, seminareve dhe aktiviteteve të tjera akademike dhe të edukimit.

Palët do të mund të eksplorojnë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit të ndërlidhura me qëllimet e këtij Memorandumi.

NENI 3

ÇËSHTJET ME INTERES TË PËRBASHKËT

Palët do të promovojnë kontaktin dhe këmbimin e bursistëve, ekspertëve dhe hulumtuesve.

Palët do të nxisin studimin dhe investigimin, si dhe këmbimin e informatës rreth publikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, posaçërisht në fushat me interes të përbashkët.

NENI 4

KËMBIMI I INFORMATËS

Palët do të këmbajnë informatën dhe opinionet e ndërlidhura me tendencat dhe avancimet në informatë, investigimin ndërkombëtar në diplomaci, politikë të jashtme, marrëdhënie ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare, marrëdhëniet ekonomike me jashtë, shkencat politike dhe nëfushat e tjera relevante.

NENI 5

PROJEKTET E NDËRMARRA BASHKËRISHT

Palët do të vendosin, përmes kanaleve diplomatike, detajet dhe logjistikën e secilit projekt që e ndërmarrin bashkërisht. Për këtë qëllim, protokollet që i përshkruajnë kushtet e këmbimeve të propozuara, medoemos do të jenë të nevojshme.

NENI 6

KUSHTET FINANCIARE

Format, kohëzgjatjet dhe kushtet financiare të këmbimit dhe trajnimit të përfaqësuesve të **Palëve**, do të **rregullohen** ndërmjet tyre.

NENI 7

ZGJIDHJA E KUNDËRTHËNIEVE

Mosmarrëveshjet dhe diskutimet të ndërlidhura me interpretimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet **Palëve** përmes konsultave.

Dispozitat e këtij Memorandumi do të mund të modifikohen me pëlqim reciprok të **Palëve**.

NENI 8
HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të vazhdojë si i tillë për një periudhë tre (3) vjeçare. Do të mund të rinovohet automatikisht për periudha të njëjta kohore, vetëm nëse njëra nga Palët vendos ta përfundojë atë, përmes njoftimit me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditësh para përfundimit të Memorandumit. Përfundimi i këtij Memorandumi nuk do të afektojë realizimin e projekteve aktuale, të cilat do të vazhdojnë deri në realizimin e plotë të tyre, vetëm nëse Palët merren vesh ndryshe.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit e mëposhtëm, të autorizuar për efektet, e kanë nënshkruar këtë Memorandum,

Në Prishtinë, më _____ ditë të muajit 2014, në dy kopje origjinale në spanjisht, shqip dhe anglisht, duke qenë tekstet autentike. Në rast të divergjencës në interpretim të tij, do të vlejë teksti në gjuhën angleze.

NGA ANA E MINISTRISË SË
JASHTME TË
REPUBLIKËS SË PANAMASË

NGA ANA E MINISTRISË SË
JASHTME TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS



JOSÉ MANUEL TERÁN
Ambasadorii
Jashtëzakonshëm dhe
Fuqiplotë

SKENDER DURMISHI
Drejtori i Akademisë
Diplomatike

